

# “VALZA HOSPITALITY

## GROUP” SHPK

### AKT THEMELIMI

PËR

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Themeluesit kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 14/11/2024 në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në bazë të kushteve që vijojnë;

*Themeluesit:*

1. Zamira Gjini, atësia Ymer, lindur në Fier, më datë 10.01.1986, dhe banuese në adresën Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Papa Gjon Pali II, Nd. 5, H. 1, Ap. 29, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BR5675593, dhe Nr. Personal I65110039J, dhe
2. Valmira Halo, atësia Ymer, lindur në Fier, më datë 03.12.1987, dhe banuese në adresën Lagja 29 Nëntori, Rruga Pinellopi Piro, Nd. 18, H. 1, Ap. 5, Fier, Shqipëri, me letërnjoftim ID Nr. 033746308, dhe Nr. Personal I76203007O.

*NENI I*

Zamira Gjini dhe Valmira Halo do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajë: “VALZA Hospitality Group” Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

Aktivitet në fushën e turizmit, strukturë akomoduese hoteleri, bar, restoran alla carte dhe all inclusive, catering dhe piceri. Aktivitet ne pishina të hapura dhe të mbyllura dhe plazh privat. Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

## *NENI 2*

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri në adresën : Njësia Administrative Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Zona Kadastrale 8260, Pall. 2, H. 1, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## *NENI 3*

**KOHËZGJATJA** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

## *NENI 4*

**KAPITALI THEMELTAR** i shoqërisë është 100,000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortakët“ e shoqërisë :

- 1- Zamira Gjini, zotëruese e 1 kuote, me vlerë nominale 50,000 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 50,000 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe
- 2- Valmira Halo, zotëruese e 1 kuote, me vlerë nominale 50,000 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 50,000 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## *NENI 5*

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Bledar Gjini, atësia Jorgji, lindur në Fier, më datë 01.07.1981, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Papa Gjon Pali II, Nd. 5, H. 1, Ap. 29, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BR5675580, dhe Nr. Personal I10701168K, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.



*NENI 6*

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me rregjistrim në "Qendrën Kombëtare të Biznesit" në bazë të Ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**"VALZA Hospitality Group" SHPK**

ZAMIRA GJINI

Zamira Gjini



VALMIRA HALO

Valmira Halo  
